



Prishtinë: 29.03.2018

Kodi i ZRRE-së: V\_960\_2018

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

### Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_1584\_05\_17**;
- Ankesa e KESCO-së e datës **25.05.2017**.

në seancën e mbajtur më datë **29.03.2018**, nxori këtë:

### V E N D I M

- I **REFUZOHET** ankesa e KESCO-së ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin A. K., nga fshati Greikoc, Komuna e Therandës, me shifër të konsumatorit **DPZ - 152245** si e pa bazuar.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK\_V\_1584\_05\_17 i datës 30.05.2017.

### A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 25.04.2017 ka pranuar ankesën e parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së, i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkallës së parë për këto shkaqe: Përfaqësuesi i KESCO-së, në ankesë ka theksuar se korrigjimi i datës 09.10.2015 është në përputhshmëri të plotë me rregullat në fuqi, pasi që energjia e harxhuar nga konsumatori nuk është regjistruar e tëra në njehsorin elektrik, por vetëm 33.33% e saj si pasojë e djegies së dy nga 3 sistemet matëse, atëherë pjesa e mbetur e energjisë së harxhuar por e paregjistruar ne njehsor elektrik prej (66.66%) përmirësohet përmes korrigjimit të faturave për 6 muajt e fundit. Në ankesë theksohet se pasaktësia ne matje nuk është trajtuar si shfrytëzim i paautorizuar nga KESCO. KESCO gjithashtu thekson se ZRRE vendimin e saj e mbështet në rrjedhën e energjisë elektrike aktive vetëm për periudhën 02/2016 deri më 07/2016 duke e krahasuar me periudhën 02/2015 deri 07/2015, por që është dashur të bëhet krahasimi edhe me periudhat tjera më të gjata, pasi konsumatori nuk ka vazhdimësi të shpenzimeve dhe kjo vërehet në periudha tjera.

Bazuar në këtë KESCO kërkon nga Bordi që të pezulloi vendimin e DMK/ZRRE \_V\_1584\_05\_17, në lidhje me shifrën DPZ - 152245 si të pabazuar.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 29.03.2018 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për



Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejt dhe i bazuar në prova konkrete.

Lidhur me pretendimet e përfaqësuesit të KESCO-së, se korrigjimi i datës 04.06.2015 është në përputhshmëri me dispozita ligjore të rregullave në fuqi, për Bordin pretendimet te tilla janë vlerësuar si të paqëndrueshme për faktin se nga analiza e bërë rrjedhës së energjisë elektrike konsumatori nuk ka mos përputhje të shpenzimeve mes njehsorit të vjetër elektrik nr.17735359 dhe njehsorin e ri elektrik nr. 16076420.

Bordi i ZRRE ka analizuar shpenzimin e energjisë elektrike të konsumatorit dhe se sipas rrjedhës së energjisë elektrike vërehet se mesatarja e shpenzimeve me njehsorin e vjetër nr.17735359 për periudhën 02/2015 - 07/2015 është 1,698.33 kWh/muaj, kurse me njehsorin e ri elektrik nr.16076420 për periudhën 02/2016 - 07/2016 është 1,759 kWh/muaj, e që krahasuar shpenzimin e njehsorit nr.16076420 me njehsorin nr.17735359 paraqet rënie të shpenzimit.

Bordi ka analizuar edhe shpenzimin e energjisë elektrike të atij muaji kontestues dhe ka vërejtur se konsumatori ka rënie të shpenzimit për periudhën 07/2015 me njehsorin nr.17735359 ku dallimi me muajin paraprak periudha **06/2015** është **628 kWh** apo shprehur në përqindje **44%**, e që kjo vërteton se njehsori **nr. 17735359** mund të mos ketë regjistruar saktë energjinë e shpenzuar. Me qëllim të vërtetimit të konsumit të mundshëm, Bordi ka analizuar dhe kalkuluar energjia njëmuajore bazuar në pajisjet që posedon konsumatori me rastin të evidentimit të pajisjeve nga punëtorët e autorizuar gjatë ndërrimit të njehsorit elektrik, e të cilat pajisje janë evidentuar nga vet punëtorët e KEDS-it, dhe konstaton se kjo energji është **787 kWh**. Nga kjo shihet se kjo energji i përafrohet edhe ndryshimit në mes të shpenzimit të energjisë elektrike (kilovatorë – kWh) të regjistruar në periudhën 06/2015 dhe 07/2015

Sipas nenit 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Rregullës për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji theksohet: *“konsumatorët kanë obligimin që të paguajnë për energjinë e shfrytëzuar, sipas kontratës për Furnizim me Energji të lidhur me Furnizuesin e Energjisë, si dhe për tarifën për shfrytëzim të sistemit të miratuara nga ZRRE-ja”*. Bazuar në këtë dispozitë ligjore është konstatuar se në rastin konkret konsumatori ka obligim që të paguaj për atë që ka shpenzuar, por që jo të ngarkohet pa bazë për rastet që kanë probleme teknike në njehsorin elektrik. Andaj edhe është kërkuar të shkarkohet konsumatori nga korrigjimi i ngarkuar nga KEDS dhe se është kërkuar të bëhet korrigjim plotësues duke i shtuar shpenzimin e energjisë elektrike (kilovatorë – kWh) të faturuar për periudhën **07/2015** prej **787 kWh**, kurse për periudhën deri me datën 17.08.2015 të faturoj vetëm me **787 kWh**, por duke anuluar faturën **0815123002DPZ-152245** në vlerë **8.02 €**.

Bordi i ZRRE gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejt dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 29.03.2018 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

**III.** Vendimi nxirret në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

**IV.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimin të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

**Bordi i Rregullatorit:**

---

Arsim Janova, u.d. kryesues

---

Besim Sejfiqaj, anëtar

---

Selman Hoti, anëtar

---

Izet Rushiti, anëtar

**Vendimi iu dërgohet:**

- KESCO-së, dhe
- Konsumatorit A. K. dhe,
- Arkivit të ZRRE-së